

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË SELENICË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Selenicë me objekt: “Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 162, datë 19.12.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 991/6 , datë 19.12.2012 , dërguar z. **Ferdinant ALIGJONI**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE

1- Të hartohet Rregullore e Brendshme për organizimin dhe funksionimin administratës së Bashkisë dhe të dërgohet për miratim në Këshillin e Bashkisë sipas kërkesave të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore.

Brenda muajit Janar 2013

2- Nga nëpunësit zbatues në Bashkinë Selenicë të krijohen regjistrat e riskut, vlerësimit të kontrollit të Brendshëm të risqeve të cilat cenojnë arritjen e objektivave të përcaktuara, në zbatim të pikës “d” të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2011 "Për Menaxhimin Financiar dhe të Kontrollit.

Menjëherë

3- Nga Bashkia Selenicë, ti propozohet Këshillit Bashkiak për miratim në strukturë të funksionimit të zyrës Juridike.

Brenda muajit Janar 2013

4- Të krijohet “Zyra e Arkivit” për arkivimin e dokumentacionit të Bashkisë, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Menjëherë

5- Nga Zyra e tatim-taksave, urbanistikës, e bujqësisë dhe mbrojtjes së tokës, policisë bashkiake dhe inspektoratit ndërtimor:

a. Të ushtrojnë kontroll për subjektet e paregjistruara që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë dhe të merren masa për regjistrimin e tyre;

b. Për subjektet të cilët nuk kanë shlyer detyrimet tatimore, t’i kërkohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, Vlorë, vendosja e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, vendosja e barrës në pasuritë e paluajtshme, bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar.

c. Punonjësit e Zyrës së Taksave dhe të Policisë Bashkiake, të hartojnë paketa me llojet dhe masat e gjobave, duke i propozuar Këshillit Bashkiak, të vendosë masën e gjobës për llojet e çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 6 “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative”, për subjektet e mëposhtme:

- “██████████” sh.p.k. me përfaqësues ligjor ██████████

- “██████████” sh.p.k me përfaqësues ligjor ██████████
- “██████████” sh.p.k. me përfaqësues ligjor ██████████, të cilat ushtrojnë aktivitet të paligjshëm.

Menjëherë

6- Në të ardhmen rekrutimi i punonjësve të bëhet sipas kërkesave të nenit 13 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil” (zyra e taksave, e bujqësisë, e administratës, Inspektoratit Ndërtimor, duke bërë zëvendësimin e ██████████ me arsim 8-vjeçar, etj).

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7- Të plotësohet dosja e personelit me të gjitha kërkesat sipas aneksi I, II të VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe regjistrimit personelit” si dhe të hartohet kontrata “TIP” me të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punëmarrësit, siç përcaktohet në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës" i ndryshuar.

Në vazhdimësi

8- Të merren masa për fillimin e procedurave për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin e plotë, azhurnimin dhe marrjen në dorëzim të objekteve, pronë e Bashkisë dhe të aplikohet në ZVRPP Vlorë, për regjistrimin sipas listës emërore të pronësisë.

Menjëherë

9- Të rakordohet me Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark dhe ZVRPP Vlorë, për evidentimin, administrimin dhe përdorimin e tokës bujqësore disponibël në juridiksionin e komunës.

Brenda datës 31.3.2013

10- Punonjësit e policisë bashkiake të pranohen në detyrë, vetëm pasi të kenë marrë formimin në Akademinë e Rendit Publik apo Akademinë e Policisë së Rendit dhe emërimi në detyrë të bëhet me komision të posaçëm.

Brenda datës 31.3.2013

11- Policia Bashkiake dhe zyra e taksave vendore, të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë për rakordimin dhe marrjen e masave ndaj të gjitha subjekteve të pa regjistruar dhe ndaj atyre që nuk kanë derdhur detyrimet vendore.

Në vazhdimësi

12- Policia Bashkiake dhe Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë, të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë për çdo rast në evidentimin dhe ndalimin e ndërtimeve pa leje, brenda territorit administrativ të njësisë dhe sipas rastit deri në prishjen e objekteve ndërtimore të ngritura pa leje ndërtimi, apo në kundërshtim me atë të miratuar.

Në vazhdimësi

13- Policia Bashkiake dhe zyra e taksave të mbajnë korrespondencë të protokolluar ndërmjet tyre, si për subjektet e palicencuara ashtu dhe ndaj atyre që nuk kanë derdhur detyrimet vendore.

Në vazhdimësi

14- Punonjësit e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë, të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

Brenda datës 31.3.2013

15- Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë, të hartojë planet vjetorë, për ushtrimin e kontrolleve sipas drejtimeve të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 dhe neneve 3, 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Në vazhdimësi

16- Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë në të gjitha rastet, kur konstaton objekte pa leje ndërtimi dhe shtesa kati pa leje mbi objektet ekzistuese, për të cilat është mbajtur procesverbal, duhet të vazhdojë procedurat ligjore për pezullimin e punimeve, vendosje gjobe, deri në marrjen e vendimit për prishje objekti.

Në vazhdimësi

17- Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë, të ushtrojë kontrolle të vazhdueshme në të gjithë territorin nën administrim dhe të mos lejojë fillimin e punimeve nga ana e subjekteve, pa u pajisur më parë me leje ndërtimi.

Në vazhdimësi

18- Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë, të marrë masat për të gjitha rastet kur subjektet ndërtuese nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore në fushën e ndërtimit:

- Të vendosë gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.
- Të paraqesë pranë organeve përkatëse kërkesë për heqje licence profesionale, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit.
- Të vendosë prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm.
- Të përgatisë kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe ti paraqesë ato pranë organeve përgjegjëse.

Në vazhdimësi

19- Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë të bashkëpunojë rregullisht me Zyrën e Financës, duke kërkuar dhe rakorduar arkëtimin e gjobave të vendosura nga INU, për të gjithë subjektet. Në të gjitha rastet kur konstatohet mos shlyerja e detyrimeve, inspektori të pezullojë punimet e ndërtimit, deri në shlyerjen e plotë të gjobave.

Në vazhdimësi

20- Nga Zyra e Tatim Taksave pas rakordimit me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë të nxjerrë njoftimin tatimor për subjektin [REDAKTUAR] mbi arkëtimin e Taksës së Rentës Minerare, në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”. Kjo procedurë të ndiqet për të gjithë periudhën e audituar e në vazhdim në zbatim të neneve 70 e 73 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”.

Menjëherë

21- Nga ana e Bashkisë Selenicë në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Prefektin e Qarkut Vlorë të merren masa për verifikimin e ligjshmërisë së aktivitetit të tyre minerar-tregtar dhe të ndalohet aktiviteti i paligjshëm nga 2 subjektet e mëposhtme:

[REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për të cilët është konstatuar se në territorin e Bashkisë kanë zhvilluar aktivitetet pa leje për shfrytëzimin e mineralit të bitumit me sistem “karrierë” dhe dëmtuar mjedisin.

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

- *Mbështetur në nenin 608, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil” i ndryshuar, të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat si më poshtë:*

1- Nga Bashkia Selenicë, të ndiqen të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **712,469 lekë**, në mënyrë analitike është si më poshtë:

- Për 12 persona në vlerën 41,159 lekë për mos llogaritje të saktë për çmimin e tokës të marrë me qira sipas VKM nr. 830, datë 28.12.1998 sipas listës bashkëngjitur;

-Për 7 persona (10 raste) në vlerën 649,310 lekë sa shpërblyer për volum pune me kohë pune, ndërsa duhet me volum pune në sasi sipas listës bashkëngjitur;

-Për 10 persona në vlerën 22,000 lekë sa paguar padrejtësisht për udhëtim e dieta sipas listës bashkëngjitur.

Menjëherë

2-Të shlyhen detyrimet në vlerën 2,969,716 lekë nga 55 subjekte biznesi që nuk kanë shlyer detyrimet.

Menjëherë

A. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141, 153 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, si dhe në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, kërkojmë nga Kryetari i Bashkisë Selenicë, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Zgjidhje e kontratës së punës” neni 153 pika 1 dhe 2, për:

■■■■■■ me detyrë Punonjës i Policisë Bashkiake, pasi:

Nuk ka formimin e duhur akademik;

Nuk ka punuar me plane pune të planifikuara;

Nuk ka aplikuar gjoba ndaj subjekteve që nuk kanë paguar detyrimet, ambulanteve të ndryshëm që shesin në rrugë, ndërtimet pa leje, zënie të hapësirave publike, dhe ndotje e mjedisit;

Nuk ka bashkëpunuar me Zyrën e Tatim/Taksave, për arkëtimin e detyrimeve subjekteve debitore dhe nuk ka ushtruar kontrole mbi territorin nën administrim, duke mos pasur evidenca për ushtrimin e aktivitetit nga subjekte të pa licencuara dhe për subjektet të cilët mund të operojnë në treg të përgjithshëm nuk ka vepruar ashtu siç përcakton neni 49 pika 2/a të ligjit nr. 8560 datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

■■■■■■, me detyrë Inspektor i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik, pasi:

Nuk ka formimin e duhur akademik;

Nuk ka kryer ushtrimin e plotë të funksionit të kontrollit të territorit në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës e për rrjedhojë mos respektim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9780 datë 16.7.2007, pasi nuk kanë ushtruar kontrole dhe konkretisht:

Nuk ka ndëshkuar me gjobë subjektet ndërtuese që nuk kanë njoftuar për fillimin e punimeve, sipas nenit 15 të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998.

“Vërejtje me paralajmërim” neni 37, për:

██████ me detyrë Specialistë e Protokollit, për shkelje të kryera në cilësinë e ish-Përgjegjëses së Administratës, pasi:

Nuk ka mbajtur regjistrimin e personelit dhe nuk ka plotësuar dosjet e secilit punonjës të rekrutuar në punë, sipas përcaktimeve të VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes dhe regjistrimit personelit” dhe ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Genci Koka, Sotir Kozdine, Piro Imeraj dhe Julian Adili. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Bajram Lamaj, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT